

Titulli i publikimit:

VETËQEVERISJA LOKALE PROAKTIVE: Komuna e Ulqinit

Botues:


OJQ „Horizonti i Ri“

Lagja Kodra pn, Ulqin

Tel: +382 68 300 603

E-mail: horizon@t-com.me

www.ngo-horizonti.org

 newhorizonngo

Për botuesin:

Nazif Veliqi

Hulumtues:

Admir Gjoni

Nazif Veliqi

Bashkëpunëtorë në hulumtim:

Allmir Çausi, Suela Avdiq,

Media partner:



Faqësja dhe dizajni:


Alma Sulejmanoviç

Shtypi:

L&G Design

Ulqin, tetor 2017

Ky dokument u publiku në kuadër të projektit WeBER - Programi i granteve të vogla për organizatat e shoqërisë civile, për monitorimin e reformës së administratës publike në nivelin lokal, të cilin e financon Bashkimi Evropian dhe Ambasada e Mbretërisë së Holandës. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e OJQ “Horizonti i Ri” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian dhe të Mbretërisë së Holandës.



HYRJE

Strategjia e Reformës së Administratës Publike në Mal të Zi 2016-2020 u miratua në vitin 2016. Struktura e Strategjisë është e bazuar në dokumentin “Parimet e Administratës Publike”, të cilin e hartoi SIGMA¹. Këto parime paraqesin standardet evropiane në këtë lëmi dhe shërbejnë si kornizë për vlerësimin e gjendjes dhe progresit në administratën publike.

Përgjegjshmëria, si një nga parimet kryesore të administratës publike reflektohet përmes shkallës së transparencës të organeve të pushtetit, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë shtetëror. Vetëqeverisjet vendore në Mal të Zi kanë shkallë brengosëse të transparencës, e bashkë me të edhe të përgjegjshmërisë². Në bazë të Treguesit Botëror të Qeverisjes, Mali i Zi në aspektin e ofrimit të shërbimeve administrative ka indikatorin me vlerë 60.10³ (nga 100 të mundshme), që tregon për nevojën e zbatimit të reformës së administratës publike, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe efikasitetit.

Kushtetuta e Malit të Zi u garanton qytetarëve të drejtën që të informohen dhe të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes, ndërsa Qeveria e Malit të Zi në vitin 2012 ka miratuar Ligjin për Qasje të Lirë në Informata, i cili parasheh qartë detyrimin e organeve të administratës publike që informatat t’i bëjnë të qasshme për qytetarët. Ky ligj ka pësuar ndryshime dhe plotësime në maj të vitit 2017.

Administrata e përgjegjshme vendore duhet të ketë faqen aktive të internetit, në të cilën do të publikohen të gjithë informatat relevante dhe të qasshme për publikun, me qëllim rritjen e besimit të qytetarëve në institucione dhe rritjen e interesimit të tyre për t’u përfshirë në procesin e vendimmarrjes.

Konsiderojmë se qasja në informacione që posedojnë organet e Komunës është mekanizëm shumë i rëndësishëm i përgjegjshmërisë, në marrëdhënien e administratës vendore me qytetarët. Komuna transparente dhe e përgjegjshme është e kushtëzuar me të drejtën e qytetarëve për qasje në informata, të cilat i posedon ajo. Mirëpo, gjendja reale në Komunën e Ulqinit dallon nga ky konstatim.

Ky hulumtim fokusohet në parimin e përgjegjshmërisë, i cili është një nga shtyllat e Reformës së Administratës Publike. Zbatimi i këtij parimi më së shumti pasqyrohet në të drejtën për qasje të lirë në informata me rëndësi publike, si dhe në praktikën e publikimit proaktiv të informatave nga organet e administratës.

Përmes këtij procesi kemi monitoruar se si organet e qeverisjes vendore të Komunës së Ulqinit, zbatojnë Ligjin për Qasje të Lirë në Informata, veçanërisht, sa e respektojnë rregullin e publikimit proaktiv të informatave për punën e tyre. Hulumtimin e filluam me monitorimin e zbatimit të parimit të përgjegjshmërisë në Kuvendin e Komunës e pastaj edhe në nivel të tërë Administratës Vendore.

Njëkohësisht kemi monitoruar dhe evidentuar se cilat informacione organet e Komunës nuk i publikojnë edhe në gjuhën shqipe – gjuhë e cila është në përdorim zyrtar në Administratën Vendore.

¹ <http://www.sigmaweb.org/publications/Principles-Public-Administration-Overview-MNE.pdf>

² Metamorphosis Foundation for Internet and Society. Mapa puta za dobro upravljanje u državnim institucijama u Crnoj Gori. Skoplje. Macedonia. 2016. Fq. 17

³ World Bank. 2017. World Governance Indicators. Interactive data access. Montenegro. Marrë nga <http://info.worldbank.org/governance/wgi/index.aspx#reports>

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata të Malit të Zi, i cili rregullon qasjen e lirë në informata, organi i pushtetit është i obliguar që në faqen e vet të internetit të publikoj informatat në vijim:

- 1) Udhëzuesin për qasje në informata;
- 2) Regjistrat publik dhe evidencat publike;
- 3) Programet dhe planet e punës;
- 4) Raportet dhe dokumentet e tjera për punën dhe gjendjen në fushat e kompetencës së vet;
- 5) Draftet, propozimet dhe tekstet përfundimtare të dokumenteve, planeve strategjike dhe të programeve për zbatimin e tyre;
- 6) Draftet, propozim-ligjet dhe rregulloret tjera, si dhe mendimet e ekspertëve për këto akte;
- 7) Aktet e posaçme dhe kontratat për mjetet financiare në dispozicion nga të ardhurat publike dhe prona shtetërore;
- 8) Listën e zyrtarëve dhe nëpunësve shtetëror, me titujt e tyre zyrtarë;
- 9) Listën e funksionarëve publik dhe listën e llogaritjes së të ardhurave të tyre mujore dhe të ardhurave të tjera, si dhe të kompensimeve lidhur me kryerjen e funksionit publik;
- 10) Vendimet dhe aktet e tjera të veçanta të cilat janë me rëndësi për të drejtat, detyrimet dhe interesat e personave të tretë;
- 11) Informatën për të cilën është miratuar qasja sipas kërkesës.

SIKUR KOHA TË KETË NDALUAR

Një nga parakushtet e administrimit të mirë lokal është mundësia e komunikimit të qytetarëve me këshilltarët që ato i zgjedhin. Kjo nënkupton krijimin e kontaktit të drejtpërdrejtë me qëllim rritjen e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, si dhe rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë të përfaqësuesve legjitim të qytetarëve, por edhe të transparencës në punën e tyre. Është e pakuptueshme që organet e Qeverisjes Vendore nuk kanë krijuar dhe nuk i shfrytëzojnë mënyrat moderne të komunikimit me qytetarët.

Neni 12 i Ligjit për Qasje të Lirë në Informata parasheh që organi i pushtetit është i obliguar që në faqen e vet të internetit të publikojë, përveç tjerash, edhe listën e funksionarëve publik⁴. Kuvendi i Komunës së Ulqinit posedon seksionin e veçantë në kuadër të faqes zyrtare në internet të Komunës së Ulqinit⁵. Mirëpo, duke kërkuar respektimin e parimit të përgjegjshmërisë, në pajtim me procesin e Reformës së Administratës Publike nga aspekti i punës së këtij organi, mund të konkludojmë se ky parim është respektuar pjesërisht, meqë vetëm një numër i vogël i informatave është i disponueshëm për qytetarët. Mosrespektimi i parimit të përgjegjshmërisë mund të vërehet në listën e këshilltarëve të këtij organi të Vetëqeverisjes Vendore në faqen ekzistuese të internetit. Përbërja aktuale e Parlamentit të Ulqinit është konstituuar me 24 shkurt të vitit 2014 dhe prej atëherë, të paktën sa i përket listës së këshilltarëve të paraqitur në faqen e internetit, asgjë nuk është ndryshuar.

Nëse vështrojmë seksionin "Këshilltarët" do të vërejmë se nuk është evidentuar asnjë ndryshim në vendet e këshilltarëve që nga formimi i kësaj përbërje të Kuvendit. Kështu, Kryetari aktual i Komunës së Ulqinit Nazif Cungu, vazhdon të figurojë si këshilltar në faqen e internetit të Komunës. Po ashtu, nënkryetarët e Komunës, Hadixha Gjoni dhe Arjan Murati, madje edhe Ministri në Qeverinë e Malit të Zi Mehmed Zenka dhe nënkryetari i Kuvendit të Malit të Zi Genci Nimanbegu, sipas faqes së internetit të Komunës, vazhdojnë të ushtrojnë funksionin e këshilltarit në Parlamentin Lokal. Shembuj të ngjashëm ka mjaft, ndërsa e njëjta situatë është edhe me listën e anëtarëve të trupave punues të Kuvendit.

Kryetari i Komunës së Ulqinit, dy nënkryetarët, Ministri për të drejtat e njeriut dhe pakicave dhe Nënkryetari i Kuvendit të Malit të Zi, sipas faqes së internetit të Komunës së Ulqinit, vazhdojnë të ushtrojnë funksionin e këshilltarit në Parlamentin Lokal.

⁴ Ligji për Qasje të Lirë në Informata (Fleta zyrtare e Malit të Zi, nr. 044/12, 030/17)

⁵ <http://www.opstinaulcinj.com/Komuna-e-Ulqinit/103/Kuvendi-i-Komuns.shtml>

Përveç listës së gabuar të këshilltarëve, lidhjen e qytetarëve me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur e bën të pamundur edhe mungesa e informacioneve për kontaktim. Përveç Kryetarit të Kuvendit të Komunës së Ulqinit, për asnjërin nga 32 këshilltarët tjerë nuk janë publikuar biografite, adresat e e-mailit, numrat e telefonit dhe të ngjashme.

Vetëqeverisja e përgjegjshme vendore vërehet në vendosjen e kontaktit të drejtpërdrejtë me qytetarët, me qëllim të përfshirjes së tyre në procesin e artikullimit të interesave të komunitetit lokal dhe pjesëmarrjes efektive në procesin e vendimmarrjes.

Si shembull pozitiv i respektimit të parimit të përgjegjshmërisë nga ky aspekt, dëshirojmë të përmendim portalin odbornik.me⁶, i hartuar fillimisht vetëm për Kuvendin e Komunës së Beranes. Ky portal iu mundëson qytetarëve që në mënyrë më të lehtë, duke shfrytëzuar teknologjitë e reja, të komunikojnë me këshilltarët. Në këtë mënyrë ata drejtpërdrejtë marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes, gjë që detyrimisht e bënë qeverisjen vendore më transparente dhe më të përgjegjshme në punën e saj.

Kuvendi i Komunës së Ulqinit është ndër të rrallët në Mal të Zi, që tash një kohë të gjatë, drejtpërdrejtë transmeton çdo seancë në televizionin lokal "Teuta TV" dhe në radio emetuesin publik lokal. Mundësia e qytetarëve që të përcjellin dhe vëzhgojnë punën e këshilltarëve paraqet një mekanizëm të fuqishëm të përgjegjshmërisë dhe është nxitës për rezultate më të mira në punën e Kuvendit. Prandaj është shumë e rëndësishme që kjo praktikë e mirë të vazhdojë edhe në të ardhmen, madje edhe të avancohet duke vendosur incizimet e seancave në faqen e internetit. Në këtë mënyrë punimet e Kuvendit do të bëheshin të disponueshme për një opinionin edhe më të gjerë.

ONLINE ASGJË, ME QASJE TË LIRË PJESËRISHT

Në pajtim me parimin e përgjegjshmërisë, i cili ka të bëjë me mbikëqyrjen e transparencës dhe të efikasitetit të vetëqeverisjes vendore, duhet të bëhet edhe publikimi i vendimeve të miratuara dhe i procesverbaleve nga seancat e Kuvendit, në faqen e internetit të Komunës. Mirëpo, me transmetimin e mbledhjeve parlamentare përmes televizionit dhe radios, fillon dhe përfundon çdo mundësi e përcjelljes së punës së këshilltarëve në Parlamentin e Ulqinit. Në faqen e internetit nuk publikohen procesverbalet nga mbledhjet e trupave punues dhe mbledhjet e Kuvendit, as amendamentet e dorëzuara nga këshilltarët, por as pyetjet e tyre drejtuar Administratës së Komunës.

Në bazë të kërkesës për qasje të lirë në informata⁷, nga Shërbimi i Kuvendit është kërkuar që të dorëzohen procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit, me rezultatet e votimit dhe raportet nga mbledhjet e trupave punues të Kuvendit, si dhe amendamentet e dorëzuara në propozim-vendimet të cilat janë shqyrtuar në seancat e Kuvendit. Me Vendimin nr. 02-64/17-2, të datës 03.08.2017, nga Shërbimi i Kuvendit, në mes tjerash, thuhet se gjatë periudhës së hulumtimit (2016-2017), u dorëzuan gjithsej shtatë amendamente, prej të cilave pesë u dorëzuan nga këshilltarët e Kuvendit.

Po ashtu, nga tetëmbëdhjetë mbledhje të thirrura në dy vitet e fundit, të rregullta dhe të jashtëzakonshme, Shërbimi na dorëzoi vetëm procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 07.05.2017.

⁶ <http://www.odbornik.me/index.php>

⁷ Kërkesa për qasje të lirë të informatave, nr. 01-373/17

Sa i përket raporteve nga mbledhjet e trupave punues të Parlamentit Lokal dhe mundësisë së qytetarëve për qasje në këto informacione, nuk është e mundur të përcaktohet rregullsia e arkivimit dhe transparenca e evidencës së tyre, pasi në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata nuk morëm përgjigje nga Shërbimi i Kuvendit.

Shërbimi për Punë të Kuvendit ka për detyrë, në pajtim me Udhëzuesin për Qasje në Informata të cilin e ka hartuar vet, që në kuadër të evidencës që mban për punën e vet, të përfshijë edhe informatat e hollësishme për aktivitetet e Kuvendit, siç janë: raportet nga mbledhjet e Kuvendit, raportet nga mbledhjet e trupave punues të Kuvendit dhe të ngjashme.

Në bazë të faqes së internetit të Komunës së Ulqinit, mund të konkludohet se Parlamenti Lokal, në dy vitet e fundit ka mbajtur vetëm 3 mbledhje, edhe pse u thirrën gjithsej 18

Shembull i praktikës së mirë nga aspekti i përgjegjshmërisë së administratës publike është faqja e internetit e Komunës së Tivatit⁸, ku në seksionin “Kuvendi i Komunës” qytetarët kanë në dispozicion procesverbalet nga tri përbërjet e fundit të këtij organi, përkatësisht nga viti 2008 e deri më sot.

VETËM PAK VULLNET TË MIRË

Qeverisja e përgjegjshme nënkupton edhe krijimin e mundësisë që qytetarët të kenë qasje në të gjitha informatat, me procedura të përcaktuara qartë për marrjen e tyre.

Për mospublikimin e informatave në faqen e internetit të organeve të pushtetit, janë paraparë gjobat me vlerë prej 500 deri në 20.000 euro.

Me nenin 12 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata organi i pushtetit është i obliguar që në faqen e vet të internetit të publikojë udhëzuesin për qasje në informata, ndërsa me nenin 11 është përcaktuar që organi i pushtetit është i detyruar që të paktën një herë në vit të përditësojë udhëzuesin për qasje të informatave. Në faqen e internetit të Komunës, në kuadër të banerit „Qasje në Informata“, ekzistojnë udhëzuesit për të gjithë organet dhe shërbimet e Komunës së Ulqinit, pra edhe udhëzuesi për qasje në informata i Shërbimit për Punë të Kuvendit. Ky shërbim hartoi udhëzuesin e vet me 5 dhjetor të vitit 2014 dhe prej atëherë nuk e përditësoi asnjëherë, edhe pse me nenin 47 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata janë paraparë gjobat me vlerë prej 500 deri në 20.000 euro për personin juridik i cili nuk e harton, nuk e publikon ose rregullisht, e të paktën një herë në vit nuk e përditëson udhëzuesin për qasje në informata.

Pra, qytetarët mund të vijnë në situatë që, në rast ndryshimi të organizimit të brendshëm ose të procedurave për marrjen e informatave, të jenë të kufizuar në realizimin e të drejtës së tyre për informim. Vendosmëria e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e parimeve të Reformës së Administratës Publike, vihet në dyshim në rast të publikimit gjysmak të informatave. Po ashtu, duke mos zbatuar ligjin, rrezikohet edhe një nga parimet më të rëndësishme të qeverisjes së mirë, i cili kontribuon në luftën kundër korrupsionit – parimi i sundimit të ligjit.

Që qytetarët të jenë aktiv në procesin e sjelljes së vendimeve, strategjive dhe programeve zhvillimore të komunitetit të vet, parimi i përgjegjshmërisë parasheh mundësinë që qytetarët të informohen për dokumentet e miratuara me rëndësi për komunitetin lokal. Po ashtu, sektori civil me qëllim të kryerjes së funksionit të vet, duhet të ketë qasje në dokumentet e miratuara ose në procesin e hartimit të akteve që kanë të bëjnë me politikat publike. Rëndësia e këtij aspekti të përgjegjshmërisë pasqyrohet edhe në nenin 12, paragrafi 1, të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata

në të cilin më shumë se një e treta e pikave (4 nga 11) kanë të bëjnë pikërisht me obligimin për publikimin në faqen e vet të internetit, të dokumenteve që miraton organi i pushtetit e në këtë rast Parlamenti Lokal.

Nga ajo që cekëm më lartë rrjedh se „Vendimet e miratuara“⁹ janë ndoshta kategoria më e rëndësishme në kuadër të prezantimit online të Kuvendit të Komunës së Ulqinit. Përkundër kësaj, gjatë dy viteve të fundit Parlamenti Lokal ka publikuar në faqen e internetit vetëm njëzet e nëntë (29) vendime, programe, raporte dhe përfundime, edhe pse numri real i dokumenteve të miratuara është shumë më i madh.

Me përgjigjen¹⁰ në kërkesën e dorëzuar për qasje të lirë në informata, nga Shërbimi i Kuvendit, fituam informatën që në periudhën mars – korrik 2016 në Parlamentin e Ulqinit janë miratuar 71 vendime, gjersa në dhjetor të po këtij viti u miratuan edhe 11 dokumente të ngjashme. Po ashtu, edhe në seancën e parë të rregullt në vitin 2017 (mars-prill), këshilltarët e Kuvendit miratuan 31 vendime. Kjo do të thotë që gjatë periudhës raportuese Kuvendi i Komunës së Ulqinit ka miratuar gjithsej 113 vendime, prej të cilëve 29 u publikuan në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Ulqinit.

Gjatë periudhës raportuese Kuvendi i Komunës së Ulqinit ka miratuar gjithsej 113 vendime, prej të cilëve vetëm 29 janë publikuar në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit.

Lidhur me këtë, mund të konkludojmë se parimi i përgjegjshmërisë u respektua proporcionalisht në pajtim me dokumentet e publikuara. Edhe pse pikat e Ligjit që i dedikohen kësaj çështjeje përbëjnë më shumë se një të tretën e obligimeve të organit shtetëror, në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit publikohen më pak se

një e treta e vendimeve. Pra, disa vendime të rëndësishme, siç është Vendimi për Zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës; Vendimi për Ndryshimet dhe Plotësimet e Vendimit për Buxhet për vitin 2016, ose Vendimi për Emërimin e Anëtarëve të Trupave Punues të themeluar nga Kuvendi, nuk janë publikuar në kategorinë e përmendur të faqes së internetit të Komunës. Po ashtu, Vendimi për Buxhet për vitin 2016 dhe për vitin 2017, i publikuar në kuadër të banerit të veçantë „Buxheti i Komunës“, nuk është publikuar edhe në kuadër të kategorisë “Vendimet e miratuara”, edhe pse këto dokumente i miraton Parlamenti.

Nga përgjigja që morëm në bazë të kërkesës për qasje në informata, konkludua se Shërbimi i Kuvendit mban evidencë të rregullt dhe ka në posedim çdo vendim që miraton Parlamenti Lokal. Prandaj mund të themi se shkalla e transparencës potenciale reaktive është në nivel të kënaqshëm. Po ashtu, në bazë të Ligjit për Publikimin e Dispozitave dhe të Akteve tjera¹¹, çdo vendim është publikuar në Fletën Zyrtare të Malit të Zi. Sipas kësaj, mund të thuhet se, mungesa

Shërbimi për Punë të Kuvendit nuk është paraqitur aspak në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, si njësi e veçantë organizative, në të cilën janë të punësuar 12 zyrtarë.

e vlerësimit të rëndësishëm së transparencës proaktive dhe mungesa e kulturës së përgjegjshmërisë në organet e Qeverisjes Vendore, por dhe pasiviteti i përfshirjes së qytetarëve në krijimin e politikave publike, janë arsyet kryesore të mospublikimit të të gjithë vendimeve të miratuara në faqen e internetit të Kuvendit të Komunës së Ulqinit.

Mosrespektimi i parimit të përgjegjshmërisë pasqyrohet edhe në faktin se Shërbimi i Kuvendit nuk publikon listën e zyrtarëve dhe punonjësve me titujt e tyre, që është detyrim ligjor. Madje, në seksionin „Kuvendi i Komunës“ nuk ekziston aspak kategoria „Shërbimi i Kuvendit“ brenda të cilës

⁹ <http://www.opstinaulcinj.com/Komuna-e-Ulqinit/133/Vendimet-e-miratuara.shtml>

¹⁰ Vendimi nr. 02-64/17-2, dt. 03.08.2017

¹¹ Ligji për publikimin e dispozitave dhe akteve tjera (“Fleta zyrtare e Malit të Zi”, nr. 5, dt. 23.01.2008)

⁸ http://opstinativat.com/index.php?option=com_content&view=article&id=41&Itemid=121&lang=me

do të duhej të publikoheshin këto informata. Mirëpo, përmes Kërkesës¹² për qasje të lirë në informata, kemi mësuar se ky shërbim ka 12 të punësuar, por nuk morëm shpjegimin se cilat pozita mbulojnë ato, respektivisht cilat punë kryejnë.

Mosrespektim i parimeve bazë të përgjegjshmërisë së vetëqeverisjes vendore është edhe fakti se qytetarëve nuk iu mundësohet të kuptojnë sistemin e punës së Parlamentit Lokal. Komuna e Ulqinit është e vetmja në rajonin jugor dhe të mesëm, si dhe ndër komunat e rralla në Mal të Zi (së bashku me Beranen, Plavën...)13 e cila në faqen e vet të internetit nuk ka publikuar Rregulloren e Punës së Kuvendit. Rikujtojmë që me këtë dokument tepër të rëndësishëm rregullohet: konstituimi, organizimi, mënyra e punës dhe e vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Ulqinit; mënyra e realizimit të të drejtave dhe detyrimeve të këshilltarëve, procedura e pjesëmarrjes së qytetarëve në punën e Kuvendit dhe çështjet tjera me rëndësi për punën dhe realizimin e funksionit të Kuvendit. Prandaj, publikimi i këtij dokument ka rëndësi të veçantë për qytetarët, sepse informimi i tyre më i madh për punën e organeve të pushtetit, në këtë rast të Kuvendit, krijon parakushtet për pjesëmarrjen e tyre më të madhe në punën e vetëqeverisjes vendore, si dhe në procesin e vendimmarrjes.

Rregullorja e Punës së Kuvendit, si dokumenti më i rëndësishëm i këtij organi, nuk është publikuar në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit.

Ky fakt bënë që qytetarët të mos kenë mundësi qasjeje në mënyrën e punës së Kuvendit, gjë që drejtpërsëdrejti ndikon në lidhjen e qytetarëve me përfaqësuesit e tyre në Parlamentin Lokal, duke zvogëluar ndikimin e tyre në efikasitetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë e përfaqësuesve legjitim të qytetarëve.

QYTETARËT TË (PA)INTERESUAR PËR SHQYRTIMET PUBLIKE

Shqyrtimi publik është një nga mekanizmat kryesor për përfshirjen e qytetarëve në procesin e sjelljes së vendimeve, planeve dhe dokumenteve strategjike. Ai nënkupton përfshirjen e opinionit të interesuar (institucioneve publike, sektorit civil dhe qytetarëve) në fazën fillestare të përgatitjes së dispozitave komunale. Hapat kryesor për përfshirjen e qytetarëve në shqyrtimet publike janë:

- Publikimi në faqen e internetit të vetëqeverisjes vendore i listës së dispozitave për të cilat do të mbahet shqyrtimi publik;
- Publikimi i thirrjes për pjesëmarrje në konsultime të opinionit të interesuar në faqen e internet të vetëqeverisjes vendore, përpara hartimit të draftit të vendimeve dhe akteve tjera;
- Publikimi i thirrjes për pjesëmarrje në shqyrtimin publik në faqen e internet të vetëqeverisjes vendore,
- Publikimi i raportit nga shqyrtimi publik në faqen e internet të vetëqeverisjes vendore.

Me Rregulloren për procesin dhe mënyrën e organizimit të shqyrtimit publik në përgatitjen e ligjeve¹⁴, në nivel qendror janë vendosur „konsultimet paraprake“, që do të thotë se ekziston detyrimi që para përpilimit të draftit të ligjit, të bëhet procesi i konsultimeve. Kjo iu jep qytetarëve dhe sektorit civil mundësi shtesë që të përfshihen me kohë në procesin e sjelljes së vendimeve.

¹² Shkresa e KK Ulqin, nr.02. dt. 03.07.2017

¹³ Faqet e Internetit të Komunave në Mal të Zi

¹⁴ "Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 12/2012, me 24.02.2012

Duke u bazuar në këtë praktikë të organeve shtetërore mund të konkludojmë se është më se e nevojshme miratimi i një akti të veçantë në nivel lokal, i cili do të rregullonte procesin e organizimit të shqyrtimit publik në përgatitjen e dispozitave komunale.

Me Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore, por edhe me Statut të Komunës së Ulqinit15, është definuar që Komuna duhet të hartojë planin e pjesëmarrjes së qytetarëve në sjelljen e vendimeve dhe të caktojë organin i cili do të organizojë shqyrtimin publik. Detyrimi i komunës është që të definojë mënyrën e përfshirjes së qytetarëve para miratimit të programeve zhvillimore të komunës, të planeve hapësinore dhe urbanistike, të buxheteve dhe akteve të përgjithshme me të cilët përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve.

Ligji për Vetëqeverisjen Vendore i obligon komunat që të sjellin Vendimin për Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Kryerjen e Punëve Publike. Komuna e Ulqinit nuk e ka sjellë këtë vendim.

Po ashtu, kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal, Ligji për Vetëqeverisje Vendore përcakton që komunat duhet të sjellin **Vendimin**

për Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Kryerjen e Punëve Publike. Sipas këtij vendimi organet e komunës janë të detyruar që të informojnë qytetarët për mekanizmat dhe format e pjesëmarrjes së tyre në procesin e vendimmarrjes dhe të krijojnë kushtet për zbatimin e tyre. Komuna e Ulqinit, edhe përkundër kërkesave dhe iniciativave të shumta të OJQ-ve lokale, nuk e solli këtë vendim, gjë që paraqet pengesë shtesë në këtë fushë.

Shkalla e përgjegjshmërisë së organeve të qeverisjes, nga ky këndvështrim, nuk pasqyrohet dhe nuk varet vetëm nga transparenca e informimit të qytetarëve por edhe nga qasja proaktive ndaj tyre me qëllim rritjen e interesimit që të marrin pjesë në shqyrtime.

Nga ky aspekt i përgjegjshmërisë, Komuna e Ulqinit në faqen zyrtare të internetit, gjatë periudhës raportuese, ka publikuar 20 njoftime për mbajtjen e shqyrtimeve publike. Nga ky numër, dy janë organizuar nga Ministria për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Turizëm dhe kishin të bënin me Draftin e Ligjit për Planifikim dhe Ndërtim dhe Draftin e Planit me dedikim të veçantë për zonën bregdetare.

Komuna e Ulqinit në faqen e vet të internetit, në dy vitet e fundit, ka publikuar 20 njoftime për mbajtjen e shqyrtimeve publike.

Parimi pjesëmarrës i qeverisjes së mirë vendore përfshinë edhe kornizën kohore për shqyrtime publike, respektivisht periudhën racionale kohore e cila duhet të

jetë në dispozicion të qytetarëve me qëllim përgatitjen e tyre për pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes. Me Ligjin për Vetëqeverisje Vendore është definuar që shqyrtimi publik nuk mund të zgjasë më pak se 15 ditë, ndërsa me Statut të Komunës së Ulqinit është precizuar që shqyrtimi nuk mund të zgjasë më shumë se 60 ditë.

Sipas njoftimeve¹⁶ të publikuara në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, shumica e shqyrtimeve publike të organizuara, ka zgjatur 15 ditë. Kishte raste kur për shkak të rëndësisë së vet dokumentit, periudha kohore për dorëzimin e vërejtjeve, propozimeve dhe sugjerimeve ishte më e gjatë. Në rast të shqyrtimit publik për Draftin e Planit Strategjik të Zhvillimit të Komunës së Ulqinit, afati fillestar u zgjatë për tetë ditë.

¹⁵ Statuti i Komunës së Ulqinit („Fleta zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“, nr. 5/2007, 9/2009 i 16/2011)

¹⁶ <http://www.opstinaulcinj.com/Komuna-e-Ulqinit/167/Shqyrtimet-publike-dhe-publikimet.shtml>

Mirëpo, duhet theksuar se afatet ligjore nuk respektohen gjithmonë. Në mbështetje të kësaj, mund të përmendim rastin kur për Draftin e Vendimit për Buxhet për vitin 2016 dhe Draftin e Vendimit për Përcaktimin e Vlerës së Tregut të Patundshmërive, afati nga dita e vendosjes së njoftimit në faqen e internetit e deri në ditën e mbajtjes së shqyrtimit publik, ishte vetëm dy ditë.

Për Draftin e Vendimit për Buxhet për vitin 2016 dhe Draftin e Vendimit për Përcaktimin e Vlerës së Tregut të Patundshmërive, shqyrtimi publik zgjati vetëm dy ditë.

Ky parim i pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në përgjithësi është respektuar në Komunën e Ulqinit, edhe pse ka disa shembuj të shmangies nga kjo praktikë pozitive.

Në shumicën e shqyrtimeve publike të publikuara, subjektet e interesuara, respektivisht qytetarët kishin mundësi të merrnin pjesë në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet vërejtjeve, propozimeve dhe sugjerimeve të cilat janë dorëzuar në tri mënyra:

- Në formë elektronike, në adresat e e-mailit të drejtuesve, zyrtarëve dhe punonjësve të organeve vendore,
- Në formë të shkruar, drejtpërdrejt në hapësirat e Komunës së Ulqinit,
- Me gojë, në shqyrtimet publike qendrore të cilat kryesisht janë organizuar në sallën e Kuvendit të Komunës së Ulqinit.

Në dy raste, shqyrtimet publike përveç në sallën e Kuvendit të Komunës, janë mbajtur edhe në disa bashkësi vendore rurale, siç është rasti për Propozim-Vendimin për Buxhet dhe Propozimin-Vendimin për Policinë Komunale. Në këtë mënyrë, qytetarëve të bashkësive vendore Katërkollë dhe Shtoj (vetëm për vendimin për buxhet) iu mundësua që me komentet e veta të marrin pjesë në prurjen e këtyre vendimeve me rëndësi të drejtpërdrejtë dhe të përbashkët.

Hulumtimi i Institutit Alternativa në temën e pjesëmarrjes së qytetarëve në shqyrtimet publike, për draftin e Vendimit për Buxhet për vitin 2017¹⁷, tregon që kjo mënyrë e organizimit të shqyrtimeve publike është më e suksesshme në kuptimin e pjesëmarrjes më të madhe të palëve të interesuara. Sipas këtij studimi, interesimin më të madh se si do të shpenzohen parat e tyre në këtë vit, e kishin qytetarët e Ulqinit me 60 qytetarë të pranishëm në të gjithë shqyrtimet publike. Ky numër i qytetarëve sipas këtij hulumtimi, është rezultat i organizimit të tre shqyrtimeve publike në vende të ndryshme, gjegjësisht në bashkësi të ndryshme vendore.

Sipas hulumtimit të Institutit Alternativa qytetarët e Ulqinit kanë treguar më së shumti interesim se si do të shpenzohen paratë e tyre për vitin 2017.

Interesimi i qytetarëve dhe niveli i përfshirjes së tyre në procesin e vendimmarrjes, në masë të madhe varet nga mënyra e organizimit të shqyrtimeve publike, prandaj edhe pjesëmarrja e tyre në numër dhe aktiviteti i tyre ndryshojnë.

Në mbështetje të këtij konstatimi, flet edhe Studimi për Zbatimin e Planit Lokal të Veprimtari për Luftën Kundër Korrupsionit¹⁸, të cilin e publikoi para pak kohësh OJQ „Ul info“. Sipas kësaj analize, pjesëmarrja e qytetarëve në shqyrtimet publike të mbajtura në hapësirat e Komunës së Ulqinit ishte aq e ulët, në disa raste edhe nuk kishte aspak, për këtë arsye psh. Sekretariati për Administratë dhe Veprimtari Shoqërore nuk ka përpiluar raportet përkatëse edhe pse ky është detyrim ligjor.

Edhe përkundër publikimit të thirrjeve për shqyrtimet publike dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në to, në të shumtën e rasteve raportet nga këto shqyrtime, nuk janë publikuar në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit. Nga 20 njoftimet e publikuara për mbajtjen e shqyrtimeve publike, janë publikuar vetëm 2 raporte.

Bëhet fjalë për shqyrtimin publik për Draftin e Studimit për Zonën e „Kripores së Ulqinit“ dhe shqyrtimin publik për Draftin e Aktit për Shpalljen Monument i Natyrës të „Kripores së Ulqinit“. Këto dy shqyrtime publike kanë zgjatur një javë më shumë se afati minimal i paraparë me ligj, sipas raporteve, në tubimin përfundimtar morën pjesë 60, përkatësisht 70 qytetarë. Në një nga raportet, në mënyrë të rregullt janë shënuar vërejtjet dhe komentet e qytetarëve, si dhe përgjigjet e përpiluesve, ndërsa pjesë e raportit të dytë janë vetëm propozimet dhe sugjerimet e qytetarëve të dorëzuara në formë të shkruar.

Nga 20 shqyrtime publike, vetëm për 2 prej tyre janë publikuar raportet në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit.

Qytetarët të cilët nuk marrin pjesë në shqyrtime publike, shpesh nuk kanë mundësi të informohen përmes faqes zyrtare të internetit të Komunës. Meqë në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, nuk ekzistojnë të dhënat për mbajtjen e 18 shqyrtimeve tjera publike, nuk kemi mundësi të vërtetojmë se a i përpiloi Vetëqeverisja Vendore raportet përkatëse dhe se a përmbajnë ato të dhënat për propozimet e parashtruara nga qytetarët si dhe arsyet për pranimin ose refuzimin e tyre.

Theksojmë se, sipas nenit 110 të Ligjit për Vetëqeverisje Vendore, organet e vetëqeverisjes vendore kanë detyrim të shqyrtojnë të gjithë komentet, propozimet dhe sugjerimet e mbërritura nga pjesëmarrësit në shqyrtimin publik; të hartojnë përmbledhjen e komenteve dhe qëndrimeve për pranim, respektivisht arsyet e mospranimit; të përpilojnë raportin e realizimit të shqyrtimit publik dhe t'ia dorëzojnë propozuesit së bashku me draftin e planit ose programit zhvillimor të komunës, buxhetit dhe akteve të tjerë, me të cilat përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve.

QYTETARËT MË SË SHUMTI PYESIN PËR PARA

Kushtetuta e Malit të Zi i garanton qytetarëve qasje të lirë në informata. Ligji për Qasje të Lirë në Informata përcakton lirinë e kërkimit të informatave nga persona fizik dhe juridik, të huaj dhe vendas, si dhe detyrimin e organeve të pushtetit që të ofrojnë informatat e disponueshme, si dhe procedurën e realizimit të kësaj të drejtë pranë organeve kompetente.

Po ashtu, Ligji për Vetëqeverisje Vendore dhe Statuti i Komunës së Ulqinit parashohin transparencën e punës së organeve të vetëqeverisjes vendore, ndërsa me Vendimin për Organizimin dhe Mënyrën e Punës të Organeve të Administratës Vendore, është paraparë që çdo sekretariat dhe shërbim i Komunës së Ulqinit të kryejë punët lidhur me qasjen e lirë në informata nga fushëveprimi i tyre, të parapara me Ligjin për Qasje të Lirë në informata.

Përndryshe, e drejta e publikut për të ditur paraqet aspiratën për nivelin e plotë të transparencës, e cila në themel ka bindjen e përgjithshme që demokracia është sundimi i popullit dhe se përfaqësuesit e zgjedhur janë ushtrues momental të detyrës së vendimmarrësve. Prandaj, ata duhet të jenë llogaridhënës ndaj qytetarëve.

Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2016 – 2020¹⁹ ka për qëllim realizimin më efikas të të drejtës për qasje të lirë në informata. Njohuria e pamjaftueshme e opinionit për të drejtën për qasje të lirë në informata dhe niveli i ulët i profesionalizmit të zyrtarëve në organet ku kryhen punët nga kjo fushë, janë vetëm disa nga sfidat për realizimin e këtij qëllimi.

Një nga parakushtet e njohjes së opinionit me të drejtën për qasje të lirë në informata dhe mënyrën e realizimit të kësaj të drejte, është publikimi i Udhëzuesit për Qasje në Informata në

¹⁷ <http://institut-alternativa.org/infografik-slabo-ucesce-gradana-u-raspravama-o-lokalnim-budzetima/>

¹⁸ <http://ul-info.com/studimi-per-implementimin-e-planit-te-veprimtari-per-lufte-kunder-korrupsionit-ne-komune-te-ulqinit/>

¹⁹ Miratuar në Qeverinë e Malit të Zi, me 28.07.2016

faqen e internetit të organit të pushtetit, si dhe përditësimi i rregullt i tij. Edhe pse Udhëzuesit për të gjithë organet e Komunës së Ulqinit janë të publikuara në faqen e saj të internetit, asnjë prej tyre nuk është i përditësuar. Udhëzuesi i fundit i përditësuar është ai i Shërbimit të Menaxherit, në qershor të vitit 2016.


Me qasje të drejtpërdrejtë në hapësirat e Byrosë së Qytetarëve të Komunës së Ulqinit, vërejtëm se të dhënat për dorëzimin e kërkesës për qasje të lirë në informatave nuk janë të afishuara. Edhe pse ky nuk është një detyrim ligjor, afishimi i tyre në hapësirat e Vetëqeverisjes Vendore do t'i bënte këto informata të dukshme edhe për qytetarët që nuk kanë qasje në internet.

“Heshtja e shpeshtë e administratës” në procedurat e kërkesave për qasje të lirë në informata, është një nga problemet e evidentuara në Strategjinë e lartpërmendur. Në mënyrë që të shohim nivelin e transparencës reaktive të Komunës së Ulqinit, në bazë të së drejtës për qasje të lirë në informata, nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë në Informata, kemi kërkuar²⁰ numrin e vendimeve të përcaktuara (në bazë të kërkesës për qasje të lirë në informata) nga Komuna e Ulqinit, për periudhën janar 2016 – korrik 2017. Agjencia vërtetoi që gjatë kësaj periudhe pati vetëm një vendim të përcaktuar në bazë të kërkesës për qasje të lirë në informata²¹.

Nga ana tjetër, në Studimin tashmë të përmendur për zbatimin e Planit Lokal të Veprimit për Luftën Kundër Korrupsionit në Komunën e Ulqinit, u vërtetua se numri i ankesave dhe padive ishte mbi 80, nga të cilët tetë ishin padi.

Pikërisht, shpenzimi i parave publike në bazë të kërkesave të dorëzuara për qasje të lirë në informata, është tema e cila më së shumti iu intereson qytetarëve.

Gjatë hulumtimit për zbatimin e parimit të përgjegjshmërisë në punën e organeve të Komunës së Ulqinit, konstatoam se interesi i opinionit për dorëzimin e kërkesave për qasje të lirë në informata, ndryshon në varësi të organit. Nga kërkesa²² që ia dorëzuan Shërbimit të Kryeadministratorit, u informuam se organi të cilit iu dorëzuan më së shumti kërkesa për qasje në informata, gjatë vitit 2016 dhe gjysmës së parë të vitit 2017, ishte Sekretariati për Buxhet dhe Financa – gjithsej 241. Pastaj vjen Sekretariati për Administratë dhe Veprimtari Shoqërore me 23 kërkesa të pranuar; Shërbimi për Punë të Përbashkëta 6, Qendra për Sistem Informativ 10, Sekretariati për Mbrojtjen e Pasurisë 8 dhe Sekretariati për Ekonomi me gjithsej 2 kërkesa. Në Sekretariatit për Çështje Banesore nuk mbërriti asnjë kërkesë, ndërsa organet tjera nuk u përgjigjën ose deklaruan se nuk posedojnë informacionin e kërkuar.



²⁰ Nr. 04-125-36-1, dt. 7.08.2017

²¹ Vendimi nr. 04-125-36-2, dt. 5.09.2017

²² Nr. 14-70/17, dt. 7.08.2017.

NË GJUHËN SHQIPE VETËM STATUTI I KOMUNËS

Koncepti *qeverisje e mirë* nënkupton spektrin më të gjerë të përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Qasja në informata të cilat kanë të bëjnë me dokumente të rëndësishme, aktivitete të ndryshme dhe procedura juridike për miratimin e vendimeve me rëndësi për komunitetin, duhet të jetë e siguar për të gjithë qytetarët.

Statutit i Komunës së Ulqinit është i vetmi dokument në gjuhën shqipe i publikuar në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit.

Në komunën e Ulqinit është e domosdoshme që Vetëqeverisja Vendore të mundësojë informimin e qytetarëve edhe në gjuhën shqipe. E drejta për informim në gjuhën amtare dhe e drejta për përdorimin e gjuhës dhe të shkrimit është një nga të drejtat themelore të popujve pakicë. Këtë e njeh edhe Kushtetuta e Malit të

Zi²³, e cila në nenin 13 përcakton që gjuha malazeze është gjuhë zyrtare në Mal të Zi, por që në përdorim zyrtar është edhe gjuha shqipe. Po ashtu, me Ligjin për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave²⁴ është precizuar që në vetëqeverisjet vendore në të cilat përfaqësuesit e popujve dhe të komuniteteve tjera pakicë përbëjnë shumicën ose të paktën 5% të popullsisë, sipas rezultateve nga dy regjistrimet e fundit të njëpasnjëshme të popullsisë, në përdorim zyrtar është edhe gjuha e këtyre popujve pakicë dhe e komuniteteve tjera pakicë.

Me monitorimin e punës së Kuvendit të Komunës së Ulqinit kemi vërejtur se nga fillimi i vitit 2017, si asnjë herë më parë, të gjitha materialet e kuvendit iu dorëzohen këshilltarëve në dy gjuhë, në gjuhën malazeze dhe shqipe. Transparenca proaktive dhe përfshirja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, të paktën nga aspekti tekniko – lingvistik, përfundon në këto materiale.

Në kategorinë „Vendimet e miratuara”²⁵, në kuadër të seksionit „Kuvendi i Komunës”, nuk është publikuar asnjë vendim në gjuhën shqipe. Madje, duke klikuar seksionin e sipërpërmendur, faqja e internetit të Komunës së Ulqinit me automatizëm kalon në versionin në gjuhën malazeze.

Statuti i Komunës së Ulqinit²⁶ është dokumenti i vetëm i publikuar në gjuhën shqipe, në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Ulqinit.

Nga 22 formularë të publikuar në gjuhën malazeze në kategorinë „Kërkesat dhe formularët”, vetëm Fletëparaqitja Tatimore është e publikuar në gjuhën shqipe.

Në kategorinë „Shqyrtimet publike dhe publikimet”²⁷, nga 20 njoftime për mbajtjen e shqyrtimeve publike, për 4 prej tyre është publikuar vetëm titulli në gjuhën shqipe, ndërsa për 16 të tjerët, përveç titullit, në gjuhën shqipe u publikuan edhe detajet për mbajtjen e shqyrtimeve publike. Draftet e vendimeve, për të cilët janë organizuar shqyrtimet publike, nuk janë publikuar në gjuhën shqipe. Për hir të saktësisë, Drafti i Vendimit për Policinë Komunale është publikuar pjesërisht në gjuhën shqipe dhe atë deri tek neni 7, ndërsa pjesa tjetër e dokumentit i cili përmban gjithsej 47 nene, ka mbetur në gjuhën malazeze.

²³ Kushtetuta e Malit të Zi, SU-SK Numër 01-504/21

²⁴ Ligji për të drejtat dhe liritë e pakicave, nr.31/2006

²⁵ <http://www.opstinaulcinj.com/Komuna-e-Ulqinit/133/Vendimet-e-miratuara.shtml>

²⁶ http://www.opstinaulcinj.com/upload/document/statuti_i_komuns_final_1.pdf

²⁷ <http://www.opstinaulcinj.com/Komuna-e-Ulqinit/167/Shqyrtimet-publike-dhe-publikimet.shtml>

Në bazë të nenit 110 paragrafi 1 pika 4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore „në komuna ku shumicën ose një pjesë të konsiderueshme të popullsisë e përbëjnë përfaqësuesit e popujve dhe të komuniteteve tjera pakicë, plani (i mbajtjes së shqyrtimit publik) përmban edhe mënyrën e sigurimit të pjesëmarrjes së popujve pakicë dhe komuniteteve tjera pakicë edhe në gjuhën e tyre“.

Me praktikën e mospublikimit të informatave edhe në gjuhën shqipe, Vetëqeverisja Vendore iu pamundëson qytetarëve që në mënyrë adekuate të informohen për punën e saj. Kjo padyshim që ndikon edhe në pjesëmarrjen e tyre aktive në procesin e vendimmarrjes.

Titulli i organit të Administratës Vendore	Numri i formularëve të publikuar në gj. malazeze, në faqen e internetit të Komunës	Numri i formularëve të publikuar në gj. shqipe në faqen e internetit të Komunës
Sekretariati për Financa dhe Buxhet	2	1
Sekretariati për Administratë dhe Vepr. Shoqërore	5	0
Sekretariati për Planifikim Hapësinor dhe Zhvillim të Qëndrueshëm	5	0
Sekretariati për Ekonomi dhe Zhvillim Ekonomik	5	0
Sekretariati për Veprimtari Komunale	2	0
Policia Komunale	1	0
GJITHSEJ:	22	1

Po ashtu, nga 22 formularët e publikuara në kategorinë „Kërkesat dhe Formularët“²⁸, në kuadër të seksionit „Shërbimi për Qytetarë“ në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, vetëm një (1) është publikuar edhe në gjuhën shqipe, përkatësisht **Fletëparaqitja Tatimore**²⁹. Përndryshe, gjatë monitorimit vërejtëm se edhe dokumentet tjerë të Sekretariatit për Buxhet dhe Financa, që kanë të bëjnë me njoftimet publike, përkatësisht me njoftimet për pagesën e detyrueshme të borxhit tatimor, janë publikuar në gjuhën malazeze dhe në gjuhën shqipe.

Në fund, duhet të theksohet edhe fakti se asnjë organ i Vetëqeverisjes Vendore nuk ka publikuar në gjuhën shqipe Udhëzuesin për Qasje të Lirë në Informata³⁰.

Komuna e Ulqinit në këtë mënyrë vështirëson direkt të drejtën e qytetarëve për qasje të lirë në informata. Qytetarët të cilët dëshirojnë t'i qasen informatave në gjuhën shqipe në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, ballafaqohen me mungesën e dokumenteve dhe formularëve në gjuhën e vet amtare.

Asnjë organ i Komunës së Ulqinit nuk ka publikuar në gjuhën shqipe Udhëzuesin për Qasje të Lirë në Informata

NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Ky hulumtim padyshim tregon se Komuna e Ulqinit pjesërisht publikon informatat me rëndësi publike, në faqen e vet të internetit. Edhe pse publikimi i tyre proaktiv është i detyrueshëm me ligj, Komuna e Ulqinit në mënyrë të pamjaftueshme zbaton parimin e përgjegjshmërisë së administratës publike.

Kuvendi i Komunës së Ulqinit ka vendosur tashmë praktikën e transmetimit të drejtpërdrejtë të seancave të veta në TV dhe radio. Mirëpo, mospublikimi i listës së saktë të këshilltarëve të Kuvendit, të procesverbale nga mbledhjet e këtij organi të pushtetit, si dhe të informatave për amendamentet që dorëzohen, pyetjet dhe rezultatet e votimit, vështirëson dukshëm informimin e qytetarëve për rezultatet e punës së përfaqësuesve të tyre legjitim, por njëkohësisht edhe kontrollin e punës së tyre.

Po ashtu, mospublikimi i drafteve dhe propozimeve për shqyrtim, pastaj edhe i të gjithë vendimeve që miratohen, e bën pothuajse të pamundur pjesëmarrjen e palëve të interesuara në vendimmarrje si dhe përfshirjen e tyre në krijimin e politikave publike me rëndësi për komunitetin lokal.

Komuna e Ulqinit i respekton pjesërisht dispozitat ligjore për shqyrtimin publik. Mirëpo, duke mos publikuar raportet nga shqyrtimet publike, qytetarët të cilët nuk janë pjesë aktive e këtyre aktiviteteve të Komunës, nuk mund të informohen për rezultatet e tyre.

Vetëqeverisja Vendore duhet të bëjë përpjekje shtesë nga aspekti i nxitjes së qytetarëve që të marrin pjesë në shqyrtimet publike për çështje me rëndësi jetësore për komunitetin lokal. Për shkak të funksionimit të dobët të bashkësive vendore, ndikimi i qytetarëve në krijimin e politikave lokale është shumë modest.

Komuna e Ulqinit nuk i ripërtërinë Udhëzuesit për Qasje të Lirë në Informata, ndërsa ata ekzistues nuk janë të publikuar në gjuhën shqipe. Po ashtu, udhëzimi për qasje të lirë në informata nuk është i afishuar në Byronë Qytetare të Komunës së Ulqinit.

Për shkak të informimit të pamjaftueshëm të qytetarëve me këtë instrument të pjesëmarrjes së tyre në përcjelljen e punës së organeve të pushtetit, Vetëqeverisja Vendore duhet të punojë në edukimin e qytetarëve, si dhe të përmirësojë përgatitjen e zyrtarëve të vet në kryerjen e punëve në këtë fushë. Publikimi më i madh proaktiv i informatave me interes për qytetarët, do të zvogëlojë nevojën e tyre për dorëzimin e kërkesave në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë në Informata.

Në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit publikohet një numër shumë i vogël i dokumenteve në gjuhën shqipe. Vetëqeverisja Vendore duhet të respektojë gjuhën e shumicës së popullsisë në këtë komunë, duke iu mundësuar kështu qasjen në informata në gjuhën amtare.

²⁸ <http://www.opstinaulcinj.com/Komuna-e-Ulqinit/150/Krkesa-dhe-formular.shtml>

²⁹ <http://www.opstinaulcinj.com/Krkesa-dhe-formular/2360/Sekretariati-pr-financa-dhe-buxhet--Krkesa.shtml>

³⁰ <http://www.opstinaulcinj.com/Komuna-e-Ulqinit/152/Qasje-e-lir-n-informata.shtml>

Rekomandimet

PËR TRANSPARENCËN NË PUNËN E KUVENDIT

- Të përditësohet lista e këshilltarëve në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit.
- Të publikohen informatat për kontaktin e qytetarëve me këshilltarët. Rekomandojmë që këto të dhëna (adresa e e-mailit, numrat e telefonave, koha dhe vendi i takimeve të rregullta me qytetarë) të vendosen në faqen e internetit së bashku me listën e këshilltarëve.
- Të publikohen incizimet nga mbledhjet e Kuvendit edhe në faqen e internetit të Komunës.
- Të publikohen procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit dhe të trupave punues të këtij organi, me amendamentet dhe pyetjet e dorëzuara si dhe me rezultatet e votimit, në gjuhën shqipe dhe malazeze.
- Në mënyrë të përditësuar dhe në të dy gjuhët të publikohen paralajmërimet e mbledhjeve, me rend të ditës, propozimet e vendimeve me të gjithë informatat tjera relevante të parapara me ligj, që kanë të bëjnë me pikat e rendit të ditës.
- Të publikohet në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, në kategorinë “Vendimet e miratuara”, çdo dokument të cilin e miraton Kuvendi. Njëkohësisht, të publikohet çdo vendim edhe në gjuhën shqipe.
- Në kuadër të seksionit “Kuvendi i Komunës”, të vendoset kategoria e veçantë “Shërbimi i Kuvendit”, në të cilën do të publikohet lista e zyrtarëve dhe punonjësve të këtij shërbimi, me titujt e tyre zyrtarë.
- Të publikohet Rregullorja e Punës së Kuvendit në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, në gjuhën shqipe dhe malazeze.

PËR PJESËMARRJEN E QYTETARËVE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE PUBLIKE


- Të publikohet rregullisht në faqen e internetit të Komunës, lista e dispozitave për të cilat do të mbahet shqyrtimi publik.
- Në faqen e internetit të Komunës, para hartimit të draftit të vendimeve dhe të akteve tjera, të publikohen thirrjet për pjesëmarrje në konsultime për opinionin e interesuar.
- Në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, të publikohen raportet nga të gjitha shqyrtimet publike.
- Të miratohet Vendimi për Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Kryerjen e Punëve Publike.
- Për shumicën e vendimeve të cilët i miraton Kuvendi, të organizohen shqyrtime publike në zona të ndryshme të komunës dhe për grupe të ndryshme qytetarësh. Të vendoset bashkëpunimi i vetëqeverisjes lokale me sektorin joqeveritar për organizimin e shqyrtimeve publike.

PËR TË DREJTËN E QYTETARËVE QË TË DINË

- Të publikohet Udhëzuesi për Qasje në Informata në gjuhën shqipe për të gjithë organet e Komunës së Ulqinit.
- Të afishohen të dhënat për qasje të lirë në informata në hapësirat e Byrosë për Qytetarë.
- Në kuadër të seksionit “Shërbimi për Qytetarë” të faqes së internetit të Komunës, në kategorinë “Kërkesat dhe Formularët”, të publikohen të gjithë formularët në gjuhën shqipe.
- Të publikohet Buletini periodik për punën e këshilltarëve të Kuvendit, të trupave punues të Kuvendit si dhe të Administratës Vendore në tërësi.

CIP - Каталогизација у публикацији
Национална библиотека ЦрнеГоре, Цетиње

ISBN 978-9940-651-02-2
COBISS.CG-ID 34148368



ISSN 073-0125-071-00-1



0 709940 051022 >